



Republika e Kosovës / SHKËMBI - PRISHTINË - REPUBLIKA KOSOVA
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/ Nr. 175/2022

Datë: 12 janar 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj prokurores Shemsije Asllani, prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, në pajtim me nenin 7 paragrafi 1 nën paragrafi 11 dhe nenit 34 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas Raportit të Panelit Hetimor në rastin AD.nr. 15/2021 të datës 10 janar 2022, gjatë shqyrtimit të mbajtur me datë 12 janar 2022, në seancën e këshillimit dhe votimit mori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si i bazuar Raporti i Panelit Hetimor AD.nr. 15/2021 i datës 10 janar 2021, në rastin disiplinor të prokurores Shemsije Asllani, Prokuroria Themelore në Prishtinë.
- II. **VËRTETOHET** se, prokurorja Shemsije Asllani ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
- III. Prokurores Shemsije Asllani i shqiptohet sanksioni disiplinor, **Transferim i përhershëm në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, në Departamentin e Përgjithshëm**, sipas nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës me datat 03 gusht 2021 dhe 05 gusht 2021, ka pranuar nga Autoriteti Kompetent propozimin dhe plotësim propozimin për fillimin e procedurës hetimore disiplinore ndaj Shemsije Asllani, prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, duke propozuar të hetohen veprimet e të njëjtës si dhe t'i

shqiptohet masa disiplinore Vërejtje publike me shkrim me plotësim ndryshim, Transferim i përkohshëm apo i përhershëm në një gjykatë apo prokurori tjetër të nivelit më të ulët në mbështetje të ligjit të zbatueshëm.

Me datë 24 gusht 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 7 paragrafi 1, nën paragrafi 1.25 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 12 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 12 të Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve ka nxjerr vendimin me numër KPK/Nr.611/2021, të datës 24 gusht 2021, për Themelimin e Panelit Hetimor për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.15/2021 ndaj prokurores në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, znj. Shemsije Asllani.

Me datë 19 nëntor 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 12 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 14 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve ka nxjerr vendimin me numër KPK/Nr.832/2021, i datës 19 nëntor 2021, për zgjatjen e afatit të Panelit Hetimor AD.nr.15/2021 për periudhë kohore shtesë për dy muaj, duke filluar nga data 24 nëntor 2021 deri me datë 23 janar 2022.

Me datë 10 janar 2022, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka pranuar nga Paneli Hetimor, Raportin AD.nr. 15/2021 me të cilin ka ardhur në përfundim se prokurorja Shemsije Asllani, ka vepruar në shkelje të nenit 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.10 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe dispozitave të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror, sepse e njëjta është përfshirë në sjellje qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e Prokurorit të Shtetit ose që mund të dëmton besimin e publikut në paanshmërinë dhe besueshmërinë e Prokurorit të Shtetit. Po ashtu, prokurorja Asllani ka bërë shkelje të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror, shkelje në parimet e përgjithshme si pika 1, pika 3 nën pikat a dhe c dhe pika 5 nën pika k të këtij Kodi, me rastin e përfshirjes në përgjim të znj. Asllani, përgjim i publikuar nga portali [REDACTED] i të ashtuquajturës Dosja [REDACTED], me titull: "[REDACTED] [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] - [REDACTED]".

Sipas këtij publikimi është dëgjuar një bisedë telefonike e realizuar nga prokurorja e Shtetit znj. Shemsije Asllani me një person të panjohur, N.N. Nga ajo bisedë dëgjohej se bëhet fjalë për një veturë të cilën telefonuesi thotë se ia kanë konfiskuar pa të drejtë dhe se përgjegjës e bënë Kryeprokurorin e Shtetit. Rasti i tillë penal ku e njëjta veturë ishte konfiskuar ka qenë në trajtim te Prokurori i Shtetit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, z. [REDACTED]. Për më tej në atë bisedë telefonike dëgjohej qartë fakti se prokurorja Asllani tregon që ka ndikim të madh brenda sistemit prokurorial dhe

do ta përdorë këtë ndikim për të ndërhyrë edhe në rastin e tij. Në bisedën e përgjuar kuptohet se, prokurorja vullnetarisht ka pranuar të flasë me personin N.N. Përmes asaj bisede rezulton se personi i panjohur di gjëra sekrete për prokuroren Asllani dhe i shfrytëzon të njëjtat për ta bindur prokuroren në fjalë që t'i ndihmoj në rastin e tij, gjë e cila arrihet pasi që prokurorja Asllani vazhdon bisedën dhe i premtun personit N.N, që do të interesohet dhe aq sa mundet do të ndikoj në lidhje me rastin e tij.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 12 janar 2022, pasi që ka shqyrtuar raportin e dorëzuar nga Paneli Hetimor, ka dëgjuar Raportimin e Kryesuesit të Panelit Hetimor i cili ka elaboruar të gjitha faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedurës hetimore si dhe pas dëgjimit të subjektit të hetimit disiplinor, prokurorja Shemsije Asllani, së bashku me avokatin A [REDACTED] e cila në mbrojtjen e saj duke e kundërshtuar raportin në tërësi ka deklaruar se, *“biseda e zhvilluar me personin N.N., ka qenë në cilësinë private dhe nuk është dashur të iniciohet procedura disiplinore se është prekur privatësia e garantuar me Kushtetutë. Ju betohem se, në këtë rast nuk kam pasur interes personal. Nuk kam pasur qëllim dashakeq. Qëllimi i kësaj bisede ka qenë ta mbroj institucionin, Kryeprokurorin ta mbroj prej një shantazhuesi”.*

Duke qenë se sipas Kodit të Etikës për Prokuror, prokurori gjatë gjithë kohës, në të gjitha rrethanat duhet të veproj në atë mënyrë që të nxisë besimin e publikut në dinjitet, integritet, efektivitet dhe paanshmëri, në të gjitha rrethanat, në detyrë dhe në jetën private duhet që t'i respektojë standardet e larta të sjelljes profesionale dhe personale, t'i kryejë detyrat me paanshmëri dhe kujdes, të shmangë çdo sjellje dhe situatë që mund të vërë në pikëpyetje integritetit, paanshmërinë dhe profesionalizmin, të respektojë dhe t'i përmbahet ligjit, t'i kryej detyrat bazuar në standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, prokurorja Shemsije Asllani ka dëmtuar reputacionin e Prokurorit të Shtetit. Prokurorja Asllani nuk ka pasur autorizim dhe sipas Kodit të Etikës janë të ndaluara pranimi i telefonatave edhe nëse janë sipas sugjerimeve për një çështje penale - juridike. Prokurorja Asllani nuk ka qenë e ngarkuar me lëndën penale ku ka qenë e përfshirë bashkëbiseduesi. Po ashtu, gjatë bisedës së zhvilluar nuk ka bërë ndonjë Shënim Zyrtar, prandaj komunikimi i zhvilluar i Prokurores së Shtetit, znj. Shemsije Asllani me personin e panjohur, pa menduar fare për rëndësinë e funksionit që e ushtron ka kontribuar në dështim dhe cenim të integritetit të saj.

Këshilli Prokurorial i Kosovës pas dëgjimit të Kryesuesit të Panelit Hetimor, Subjektit të Hetimit si dhe shqyrtimit, analizimit, krahasimit të provave të cekura në Raportin e Panelit Hetimor, fjalës përfundimtare të Kryesuesit të Panelit Hetimor dhe prokurores Shemsije Asllani, erdhi në përfundim se është evidente shkelja disiplinore. Dëmi që i është shkaktuar sistemit prokurorial është shumë i madh dhe ka ndikuar keq në opinionin publik, në humbjen e besimit në sistemit prokurorial sa i përket trajtimit të çështjeve ligjore-penale në harmoni me parimet bazë të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror. Mbi bazën e dëgjimit të dy pjesëve të audio-

incizimeve të sipër cekura e të plasura në opinionin publik përmes portalit [REDACTED], e ashtuquajtura [REDACTED] s", me titull: "[REDACTED]

[REDACTED] nga vetë përmbajtja-deklarimet e shprehura në ato audio-incizime nga ana e Prokurores së Shtetit, znj. Shemsije Asllani, gjatë bisedës telefonike me personin N.N., sidomos në sekuencat ku e njëjta i referohet personit N.N., se do të bëjë çmos që të i ndihmoj atij për çështjen e asaj veture të konfiskuar, në mënyrë që me kujdes të shtuar të kontaktoj me prokurorin e çështjes, [REDACTED] dhe të kuptoj se si qëndron çështja e statusit të asaj veture dhe se do të rrezikoj veten lidhur me këtë rast për interes të personit N.N., gjithë këtë pasi që personi N.N., i kishte treguar asaj se për të kishte njohuri se një person i inteligjencës së një shteti të huaj kishte fotografi komprometuese, kanë ndikuar te publiku në humbjen e besimit të sistemi prokurorial sa i përket trajtimit të çështjeve ligjore-penale në harmoni me parimet bazë të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror, siç janë: Parimi i pavarësisë, i paanshmërisë, integritetit, llogaridhënies dhe transparencës e profesionalizmit.

Po ashtu, nga përmbajtja e asaj bisede me personin N.N., nga vet deklarimet-pohimet e Prokurores së Shtetit, znj. Shemsije Asllanit rezulton se e njëjta të kishte interferuar te komisioni gjegjës i sistemit gjyqësor me rastin e përzgjedhjes si gjyqtar të ish-bashkëpunëtorit të saj profesional. Përveç tjerash nga përmbajtja e atyre audio incizimeve të publikuara rezulton fakti që subjekti i këtij hetimi disiplinor të ketë pasur kontakte me persona zyrtar të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe të ketë qenë e njohur për çështjen e asaj veture të konfiskuar, ku në një gjendje të tillë faktike e njëjta prokurore së paku do duhej të informonte Kryeprokurorin e zyrës së saj përmes përpilimit të një Shënimi Zyrtar, gjë që i njëjti subjekt nuk ka ndërmarr një veprim të tillë.

Andaj, për rastin e vërtetuar me shkelje serioze, sanksioni disiplinor "Transferim i përhershëm në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, në Departamentin e Përgjithshëm", është në përputhje me shkeljet e gjetura si në Raportin e Panelit Hetimor, sanksioni i cili do të ketë efekt pozitiv mbi vet prokuroren Asllani që në të ardhmen të veproj konform rregullave të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror.

Nga sa u tha më lartë, Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të vlerësimit të çështjes mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



T'u dërgohet:

- z. Kujtim Munishi, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;
- znj. Shemsije Asllani, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;
- Arkivit të KPK-së.